



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. 2035 Prot.

Durrës, më 11 . 11 . 2022

URDHËR I BRENDSSHËM

Nr. 124 datë 11 . 11 . 2022

Mbi

Zbatimin e Udhëzimit Nr. 2 datë 5.5.2021 "Për kriteret e kualifikimit dhe kategoritë e drejtimit të mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë"

Në mbështetje të nenit 102 gërma "c" dhe "ç" të ligjit nr. 9251 datë 08.07.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), nenit 14 gërma "g" të ligjit nr.10109 datë 02.04.2009, "Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë", Urdhërit të Kryeministrit nr.139 datë 26.08.2022 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare", si dhe nenit 33, pika 2 të Udhëzimit Nr. 2 datë 5.5.2021 "Për kriteret e kualifikimit dhe kategoritë e drejtimit të mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë"

Urdhëroj:

1. Në zbatim të pikës 3 të nenit 3, gërmës a) të nenit 5 Udhëzimit Nr. 2 datë 5.5.2021 "Për kriteret e kualifikimit dhe kategoritë e drejtimit të mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë", qendrat e trajnimit të drejtimit të mjeteve lundruese duhet të disponojnë ambjentet e përshtatshme për zhvillimin e praktikës sipas Tabelës A-VI/1-1 "Specifikime të Standardit minimal të kompetencës në teknikat e mbijetesës personale" të Kodit STCW.
2. Në zbatim të pikës 3 të nenit 3, gërmës a) të nenit 5 Udhëzimit Nr. 2 datë 5.5.2021 "Për kriteret e kualifikimit dhe kategoritë e drejtimit të mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë", qendrat e trajnimit të drejtimit të mjeteve lundruese duhet të disponojnë ambjentet e përshtatshme për zhvillimin e praktikës sipas Tabelës A-VI/1-2 "Specifikime të Standardit minimal të kompetencës në parandalimin e zjarreve dhe zjarrfikjes" të Kodit STCW.
3. Qendrat e Trajnimit të cilat janë në proces ose aplikojnë pas datës 14.11.2022, për njohjen e zhvillimit të trajnimeve të drejtimit të mjeteve lundruese për kategoritë "C" dhe "D", do të refuzohen nëse disponojnë si ambjent praktike për Prandalimin e zjarreve dhe zjarrfikjes, ambjentet e shërbimit të MZSH (Zjarrëfiksjë e qytetit).

4. Qendrat e Trajnimit të cilat janë të njohura nga Drejtoria e Përgjithshme Detare për zhvillimin e trajnimeve të drejtimit të mjeteve lundruese për kategoritë “C” dhe “D” dhe disponojnë si ambient praktike për Prandalimin e zjarreve dhe zjarrfikjes, ambientet e shërbimit të MZSH (Zjarrëfiksja e qytetit), duhet të marrin masat për plotësimin e kushteve të përmendur në këtë urdhër, në të kundërt pas datës 01.01.2023 nuk do të lejohen të ushtrojnë këtë veprimtari.
5. Ngarkohen qendrat e trajnimit për zbatimin e këtij urdhëri.
6. Të merren masat për njoftimin e menjëhershëm të qendrave të trajnimit dhe të subjekteve të cilat janë në proces njohje nga DPD.
7. Ky urdhër të afishohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme Detare : www.dpdetare.gov.al

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PAVLIN NDREU

